

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.4.09.2023*

4.09.2023  
Ora 12:08

**RENDI I DITËS**

**Projektvendimi “Për shqyrtimin e kërkesës së Partisë Demokratike të Shqipërisë,  
për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë  
Kukës, që do të zhvillohen më datë 24 Shtator 2023”.**

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ:**
  - **Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**
  - **Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, Znj. P. Doçaj**
- **Parti Politike: PDSH Z. I. Sefa, PD (Z. F. Nuri)**
- **Të tjerë: KRIIK**

**Z. I. Celibashi:** Mirëdita! Në seancën e sotme kemi në rend dite:

- Shqyrtimin e disa kërkesave për regjistrimin si subjekte zgjedhore të:
- Partisë Demokratike;
- Partia për Europeanizimin dhe Integrimin e Shqipërisë”;
- Partia Socialiste e Shqipërisë” dhe,
- Partia e Lirisë”.

Më pas disa projektvendime që lidhen me plotësimin e vakancave në disa këshilla bashkiakë.

Atëherë, fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e kërkesave për regjistrimin si subjekte zgjedhore! Fillimisht me kërkesën e Partisë Demokratike për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Kukës, që do të zhvillohen më datë 24 Shtator 2023. Po zoti Sekretar!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.4.09.2023*

**Z. Y. Merkaç:** Faleminderit, neni 64 i Kodit Zgjedhor parashikon detyrimin e çdo partie politike për të paraqitur kërkesën për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ dhe dokumentacionin përkatës për të marrë pjesë në zgjedhje. Presidenti i Republikës, ka caktuar datën 24 shtator 2023, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve të pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës. Nga Partia Demokratike, janë paraqitur dy kërkesa për regjistrimin e saj. Njëra nëpërmjet kryetarit të saj zotit Lulzim Basha dhe tjetra nga zoti Sali Berisha, për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor. Bashkëlidhur kërkesës kanë paraqitur dokumentacionin:

- Vërtetimi i lëshuar nga Gjykata së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Zyra e Regjistrimit të partive politike;
- Deklarata e angazhimit solemn;
- Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme;
- Emri zyrtar i partisë;
- Emri i kryetarit;
- Emri i personit përgjegjës për komunikim me KQZ-në;
- Emri i financierit të partisë;
- Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Ndërsa nga zoti Sali Berisha është paraqitur:

- Deklarata e angazhimit solemn dhe,
- Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me nr 1346/222 Akti, datë 25.3.2022.

**Z. I. Celibashi:** Po, zoti Sefa!

**Z. I. Sefa, përfaqësues i PDSH-së:** Faleminderit për fjalën! Së pari, unë do të kërkoja dhe në respektim të seancës, por dhe për të qenë korrekt me njëri-tjetrin, unë

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.4.09.2023*


kërkoj që kërkesat të shqyrtohen në mënyrë të veçantë, sipas rendit të ditës të kërkuar. Pika e parë e rendit të ditës, merrni vendim për pikën e parë. Pikën e dytë të rendit të ditës, merrni vendim për pikën e dytë. Se do të ndodhë siç e bëmë në 14 maj që i bashkuat në një kërkesë dhe detyruam Partinë Demokratike të regjistrohet pas 25-30 ditëve. Ju lutem, edhe për respekt të procedurës që ju ndiqni vetë personalisht, përmbajuni rendit të ditës që na keni nisur. I merrni me rradhë. Pastaj vendimmarrja është juaja, nuk ju hyjmë në vendimmarrje. Vendosni si të jetë më e mira në arsyetimin tuaj bazuar në Kodin Zgjedhor, por ju lutem shqyrtojini të ndara, faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Po, faleminderit! Zoti Nuri!

**Z. F. Nuri, përfaqësues i PD-së:** Faleminderit zoti Komisioner. Ne si palë e interesuar, përderisa përfaqësojmë dhe ne Partinë Demokratike të zotit Berisha, jemi të mendimit që çështjet duhet të bashkohen, sikundër u bashkuan dhe herën e kaluar në muajin mars dhe të shqyrtohen të dyja njëkohësisht. Ato janë të ndërthurura me njëra-tjetrën, nga zgjidhja e njëres, varet dhe tjetra. Këto çështje nuk mund të ndahen, duhen trajtuar të dyja njëkohësisht, ka vetëm një Parti Demokratike. Pavarësisht, debateve të brendshme që mund të ketë, apo diferencave dhe argumentave juridikë dhe institucionalë që janë aktualisht dhe dihen, janë fakte të njohura botërisht. Ne jemi të idesë që këto çështje duhet të shqyrtohen nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bashkarisht, faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Po, zoti Sefa!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.4.09.2023*

**Z. I. Sefa, përfaqësues i PDSH-së:** Pa dashur të bëj debat, falenderoj përfaqësuesin e një subjekti që nuk ekziston dhe nuk e kuptoj arësyen se çfarë përfaqëson, sepse Partia Demokratike ka përfaqësuesin e vet zyrtar të njohur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Gjithsesi është një kërkues që i është drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, i ka kërkuar sipas opinionit të tij dhe dëshirës së tij, për t'u regjistruar në zgjedhje. E falenderoj dhe për faktin që pranon se ka vetëm një Parti Demokratike dhe është Partia Demokratike e cila njihet zyrtarisht dhe është e regjistruar në regjistrin e partive politike, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë. Përveç kësaj, unë nuk e kuptoj këmbënguljen pse duhet të bashkohen dy kërkesat. Në rast se janë të bindur në legjitimitetin e kërkesës së tyre dhe kanë të drejtë ligjore, unë po të isha në situatë të tillë do të kërkoja të veçoja kërkesat dhe të shqyrtohej në mënyrë të veçantë... në qoftë se kanë të drejtë. Në rast se kërkon të bëhesh pengesë për regjistrimin e subjektit tjetër, patjetër që do të kërkoj të bashkohen për t'u bërë palë në proces, për të penguar regjistrimin e partisë, për t'u zgjatur në procedura gjyqësore pa fund. Pavarësisht se KAS-i dhe Kolegji Zgjedhor vendosi se nuk kanë legjitimitet, në të njëjtën situatë që është sot. Më parë vendosi që nuk ka legjitimitet dhe nuk u lejuat fare të ankohehit, se nuk ishit fare palë në proces. E kemi një rezultat të ngjashëm, mos na detyroni se është kohë e humbur të shkosh në KAS, në Kolegjin Zgjedhor, për një gjë që vendimmarrja është më e konsoliduar tani, faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Po e fundit, zoti Nuri!

**Z. F. Nuri, përfaqësues i PD-së:** Një sqarim të shkurtër. Po e marr nga fundi, në lidhje me legjitimitetin. Në Kolegjin Zgjedhor, ne si palë jemi ankuar dhe nuk na cënoi njeri legjitimitetin, madje kolegji doli me vendim. Nëse sot do të vijohet më

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.4.09.2023*

tej me shqyrtim sot, do të kemi rastin të citojmë dhe pjesë nga vetë vendimi i KAS-it dhe vendimi i Kolegjit Zgjedhor, sepse do të ketë elementë me rëndësi që vlejné për t'u shqyrtuar sot. Pastaj, përsa i përket ndërhyrjeve të para të kolegut te referencat se kush e përfaqëson Partinë Demokratike, apo nëse ne përfaqësojmë, apo jo diçka, nuk dua t'i hyj këtyre debateve, por do t'i qëndroj rrafshit institucional, faleminderit.

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit dhe besoj se i dha gjithsekush nga ju argumentat lidhur me këtë çështje. Vlerësoj se kërkesat për regjistrimin e subjekteve zgjedhore paraqiten nga partitë politike. Pra, nga pikëpamja formalo-juridike, kërkuesi është një subjekt politik, është një person juridik, i cili ka personalitet juridik, si parti politike. Sikurse e kemi arsyetuar edhe në rastin e shqyrtimit të kërkesës së Partisë Demokratike për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e datës 14 maj të këtij viti, ne jemi duke shqyrtuar kërkesën për regjistrim si subjekt zgjedhor të kësaj partie, tani për këto zgjedhje... për zgjedhjet për kryetar të Bashkisë Kukës të datës 24 shtator. Edhe pse në pikëpamje praktike do t'i shqyrtojmë të dyja kërkesat së bashku, ajo çfarë e përbën thelbin e kërkesës është kërkesa e partisë politike, Partia Demokratike për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor. Ne si KQZ jemi duke shqyrtuar pikërisht këtë kërkesë. Pra, kërkesën e Partisë Demokratike për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor. Do të vlerësojmë në shqyrtimin e kësaj kërkesë, kush ka legjitimitetin për ta paraqitur këtë kërkesë? Nëse i plotësojnë të gjitha kërkesat e Kodit Zgjedhor që ky subjekt politik të regjistrohet si subjekt zgjedhor. Edhe pse nuk kam asnjë arsye për ta fshehur që shqetësimi që mund të ketë zoti Sefa, gjithsesi në fund të fundit do të adresohet nga organet kompetente, qoftë KAS-i, qoftë Kolegji Zgjedhor në përputhje me vlerësimin që ata do t'i bëjnë edhe legjitimitetit të ankuesit ndaj vendimit të regjistrimit, apo të mosregjistrimit të një partie politike si subjekt zgjedhor. Vazhdojmë, zoti Sefa fjala për ju!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.4.09.2023*

**Z. I. Sefa, përfaqësues i PDSH-së:** Po i nderuar Komisioner! Siç jeni në dijeni, ne kemi bërë të dyja format e kërkesës për t'u regjistruar. Si në portalin elektronik që është një arritje cilësore e KQZ-së, të jem i sinqertë, dhe ju përgëzojmë për iniciativën. Gjithashtu e kemi sjellë dhe në formë zyrtare me shkresë të protokolluar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Siç e dini dispozita është e qartë, KQZ-ja nga ana formale verifikon plotësimin e dokumentacionit ligjor të paraqitur nga subjekti zgjedhor. Besoj se Partia Demokratike ka qenë korrekte me paraqitjen e dokumentacionit ligjor dhe është në kushtet për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme vendore të 24 shtatorit 2023. KQZ-ja dhe Komisioneri shohin anën formale të dokumentacionit ligjor dhe merr vendim në rast se janë plotësuar nga ana formale dokumentat e paraqitura. Besoj se kërkesa është e plotë dhe Komisioneri do të vendosë për regjistrimin e subjektit zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë.

**Z. I. Celibashi:** Po faleminderit! Zoti Nuri!

**Z. F. Nuri, përfaqësues i PD-së:** Faleminderit zoti Celibashi! Edhe ne kemi paraqitur kërkesën tonë për regjistrimin e Partisë Demokratike të përfaqësuar nga zoti Berisha për zgjedhjet vendore për kryetarin e Bashkisë Kukës që do të mbahen në 24 shtator 2023. I kemi depozituar në protokoll me shkresë zyrtare dhe gjykojmë se i plotësojmë të gjitha elementet ligjore, pavarësisht se është ky debat që e kemi bërë dhe herën e kaluar në mars për çështjen e ekstraktit të regjistrimit të gjykatës së Tiranës, të regjistrimit të partive politike. Ne vlerësojmë se jemi në kushtet që është botërisht e njohur që kryetar i Partisë Demokratike është zoti Berisha. Kemi vendimin e shkallës së parë të depozituar zyrtarisht në gjykatë, vendimin e datës 25 mars të 2022. Kemi gjithashtu dhe... këto janë regjistrimet e fundit të Gjykatës së


*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.4.09.2023*

Tiranës. Sikundër kemi dhe këtë shkresë të datës 30 gusht 2023 nga Gjykata e Tiranës, ku një kthim përgjigjeje zyrtare nga Gjykata e Tiranës ku rezulton se regjistrimet e fundit në regjistrin e partive politike, vendimi i shkallës së parë dhe më pas vendimi i apelit i datës 3 mars 2023, i cili është ende i bllokuar në Gjykatën e Lartë. Them i bllokuar se Gjykata e Lartë, në tejkallim të afateve ligjore 30-ditore nuk ka marrë vendim. Sikundër e dinë të gjithë juristët, ky është një vendim ende jo i formës së prerë. Pra, për vendimin e apelit, Gjykata e Lartë duhet të ishte shprehur brenda 30 ditëve nëse do ta kthente çështjen për rigjykim në apel, apo do ta mbyllte. Përfundimisht këtë element ne duam ta bëjmë pjesë të praktikës tuaj të KQZ-së, këtë vendim, këtë shkresë zyrtare të ardhur nga Gjykata e Tiranës, sikundër kemi dhe dy dokumenta të tjerë që duam t'i paraqesim, për të argumentuar jo vetëm... Këto janë dokumenta të brendshëm të Partisë Demokratike.., duam të argumentojmë jo vetëm nevojën për regjistrimin e Partisë Demokratike me kryetar Sali Berishën, por duam t'i mëshojmë faktit se KQZ-ja nuk duhet të regjistrojë Partinë Demokratike, e cila pretendon se përfaqësohet nga zoti Basha për këto zgjedhje, për sa kohë zoti Basha ka dhënë dorëheqjen publikisht në 2021. Kjo dorëheqje e tij është pranuar publikisht dhe nga përfaqësuesi i zotit Basha në Kolegjin Zgjedhor. Mund të citoj vendimin nr. 5, të datës 23.03.2023 të Kolegjit Zgjedhor, ku në brendi shfaqet, paraqitet dhe njihet kjo vendimmarrje. Më pas Këshilli Kombëtar i Partisë Demokratike ka njohur dhe dorëheqjen e zotit Enkeled Alibeaj. Po e kujtoj për publikun “diferencën nga muaji mars”, ku ju u detyruat si Komisioner Shtetëror i Zgjedhjeve ta regjisronit Partinë Demokratike me nënkryetarin pas vendimit të KAS-it dhe më pas të Kolegjit. Nuk jemi në ato rrethana. Rrethanat kanë ndryshuar nga muaji mars. Kësaj here, as zoti Basha nuk figuron më kryetar i Partisë Demokratike zyrtarisht dhe as zoti Enkeled Alibeaj nuk figuron më nënkryetar. Ndodheni para një situatë mjaft të ndryshme dhe ne kërkojmë që të mos regjistrohet Partia Demokratike e cila ka ardhur sot me

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.4.09.2023*

përfaqësues zotin Sefa për të përfaqësuar pra, zotin Basha. Kemi këtu dy vendime dhe procesverbale të Këshillit Kombëtar të Partisë Demokratike të datës 27 korrik 2023, nr. Prot., 60, ku shihet qartë se nuk ka pas mbledhje dhe nuk ka pas vendimmarrje. Kjo është e konfirmuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Partisë Demokratike dhe këto shkresa i janë dërguar Gjykatës së Tiranës për regjistrim. Pra, ka një konflikt të brendshëm në Partinë Demokratike edhe për sa i përket udhëheqjes aktuale që zoti Sefa pretendon dhe mbi bazën e të cilës është prezent këtu sot dhe kërkon regjistrimin e Partisë Demokratike. Kështu, po i vëmë në dispozicion KQZ-së këto dokumente zyrtare dhe këmbëngul dhe një herë faktit se për regjistrimet e fundit të Gjykatës së Tiranës, kjo është e datës 30 gusht. Nëse ka regjistrime të datës 4 shtator le të na i venë në dispozicion, por regjistrimi i fundit është vetëm vendimi i apelit i 3 marsit 2023. Pra, nuk ka asnjë regjistrim këtu ku të figurojë rizgjedhja e ndonjë kryetari të ri, faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Me sa unë kuptova, ju jeni duke thënë që zoti Lulëzim Basha nuk është kryetar i Partisë Demokratike dhe nuk ka legjitimitetin që në emër të kësaj partie të kërkojë që kjo parti të regjistrohet si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e datës 24 shtator për kryetar të Bashkisë Kukës. Këtë jeni duke thënë?!

**Z. F. Nuri, përfaqësues i PD-së:** Jo vetëm zoti Basha, por as ish nënkryetari, zoti Alibeaj, sepse dorëheqja e tij ka ndodhur efektivisht më pas, është pranuar nga Këshilli Kombëtar si dorëheqje. Pra, aktualisht jemi në kushte totalisht të ndryshme nga situata e marsit, ku KQZ-ja u detyrua ta regjistronte Partinë Demokratike me nënkryetarin, pas vendimit të KAS-it dhe Kolegjit Zgjedhor.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.4.09.2023*

**Z. I. Celibashi:** Në vijim të asaj çfarë thashë, kuptojmë dhe këtë tjetrën, që ndërkohë edhe nënkryetari i Partisë Demokratike... Ose më saktë, Partia Demokratike, nuk ka nënkryetar, kështu që edhe nënkryetari, përderisa nuk e ka atë si person të emëruar, nuk do të kishte legjitimitetin për të paraqitur kërkesën për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor. Përtej kësaj, ajo çfarë është më e rëndësishme, është ajo çfarë thatë që "kryetari i Partisë Demokratike, nuk është zoti Basha", sepse ju thatë që "ai ka dhënë dorëheqjen, është një fakt i njohur botërisht dhe rrjedhimisht nuk ka legjitimitet për të paraqitur kërkesën në emër të Partisë Demokratike". Këtë po thoni?

**Z. F. Nuri, përfaqësues i PD-së:** Nëse kemi një regjistrim të ndryshëm të rizgjedhjeve, apo nuk e di se çfarë mund të pretendojë pala tjetër, në Gjykatën e Tiranës, le të na e paraqesin. Shkresa që ne sollëm që daton në 30 gusht, regjistrimi i fundit sipas Gjykatës së Tiranës, ardhur nga zv. kryetaria e gjykatës shkresa, drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë Demokratike, mban regjistrimin e vendimit të apelit. Nuk ka ngjarje të tjera të regjistruara në "Regjistrin e partive politike", të paktën sipas asaj shkrese zyrtare. Ne i referohemi shkresave.

**Z. I. Celibashi:** Kur daton regjistrimi i fundit sipas jush, ose sipas dokumentave që dispononi? Kam përshtypjen se do të dojë t'i konsultojë edhe zoti Sefa...

**Z. I. Sefa, përfaqësues i PDSH-së:** Patjetër! Dua një kopje të saj!

**Z. F. Nuri, përfaqësues i PD-së:** Kemi vënë në dispozicion kopjen origjinale KQZ-së. Mund të na japë dhe ne një kopje, sepse nuk kemi aktualisht, patjetër dhe kolegut. Regjistrimi i fundit është ai që figuron aty, që është vendimi i apelit, i 3 marsit. Pikërisht këtu e nisa duke thënë që "vendimmarrja sot është e bllokuar, procesi

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.4.09.2023*

gjqësor, të themi konflikti është bllokuar në Gjykatën e Lartë”. Dihet ngarkesa e Gjykatës së Lartë, nuk ka marrë vendim brenda 30-ditëve nga rekursi i paraqitur edhe vendimi i apelit, fatkeqësisht sot që flasim është ende një vendim i cili nuk është i formës së prerë.

**Z. I. Celibashi:** Dakord, faleminderit! Zoti Sefa, ndërkohë që po bëhet dhe fotokopja e dokumentave që kërkuat!

**Z. I. Sefa, përfaqësues i PDSH-së:** Jam shumë i lumtur që partia që pretendohet se drejtohet nga zoti Berisha, njih si Sekretar të Përgjithshëm zotin Bardhi. Është një kapërcim shumë cilësor dhe drejt bashkimit të madh të demokratëve, njohjen e institucioneve të Partisë Demokratike dhe në fund të ditës e dinë se kush është Partia Demokratike. E pranojnë dhe vetë me shkresa zyrtare dhe me kërkesa drejtuar këtij komisioni. Më vjen mirë që ky subjekt imagjinar politik ka marrë dhe këshilltarë të tjerë për të kërkuar regjistrimin si subjekt zgjedhor. Siç e dini ju zoti Komisioner, siç e dinë dhe përfaqësuesit e partive politike, Gjykata e Tiranës ka një regjistër të partive politike. Komisioneri nuk është as gjyqtar, megjithëse e ka ushtruar këtë profesion në të shkuarën e tij, por është thjesht një funksionar i administratës publike, funksionar i lartë i administratës publike, i cili sheh plotësimin e dokumentacionit ligjor nga ana formale. Kjo është ajo çfarë bën Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Kërkon vërtetim nga gjykata, kemi vërtetim nga gjykata. Kërkon numër llogarie, kemi numër llogarie. Kërkon deklaratën e betimit, kemi deklaratën e betimit. Kemi përfaqësuesin e përhershëm, kemi financierin e partisë. Komisioneri të gjithë dokumentacionin ligjor që kërkohet e ka. Pastaj nëse ka procese gjyqësore imagjinare, procese me këshilla kombëtarë me prezencë imagjinare on-line dhe të gjitha këto diskutimet e tjera janë diskutime të brendshme të Partisë Demokratike,

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.4.09.2023*


për të cilat ka organe që i zgjidhin. Kur të reflektohen në regjistrin e partive politike dhe këshilli kombëtar on-line dhe imagjinar të regjistrohët, atëherë gjykata do të marrë masa të pezullojë aktivitetin e partisë, ose do të heqë kryetarin e të gjitha me rradhë, pra punët e saj. Kur të shihni atë shkresën do ta kuptoni dhe rradhitjen e ndryshimeve që janë bërë në Partinë Demokratike. Një ndryshim është bërë në 92-shin, një ndryshim është bërë në 2005, një ndryshim tjetër është bërë në 2013, sepse ndryshohet vetëm kur zgjidhet një kryetar i ndryshëm nga ai që është. Vetëm atëherë ndryshohet regjistri i partive politike, pavarësisht se ne na qëlloi fati i madh që të kemi këto pretendime në të gjitha palët e mundshme dhe po detyrohemi që gjykata të zbatojë dhe këto diskutimet e tjera. Më vjen shumë mirë, të them të drejtë, që përfaqësuesi që pretendon që partia drejtohet nga Sali Berisha, paraqet si provë një shkresë të drejtuar nga sekretari i Përgjithshëm i Partisë Demokratike, zoti Gazmend Bardhi, besoj se përgjigja është e saktë. Për sa kohë njohin institucionet e Partisë Demokratike, se kush është institucioni i Partisë Demokratike, mendoj se kjo punë është mbyllur. I falenderojmë dhe për angazhimin e marrë që pas një beteje disa mujore, më në fund arritën në konkluzionin se Partia Demokratike drejtohet nga organet e saj legjitime ndër to dhe Sekretari i Përgjithshëm, zoti Gazmend Bardhi, faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Jeni duke thënë që zoti Bardhi është sekretar i Përgjithshëm i Partisë Demokratike?

**Z. I. Sefa, përfaqësues i PDSH-së:** Patjetër!

**Z. I. Celibashi:** Po, zoti Nuri!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.4.09.2023*


**Z. F. Nuri, përfaqësues i PD-së:** Faleminderit! Nuk e kam në natyrën time dhe nuk dua t'i hyj çështjeve, konsideratave dhe aludimeve politike, por dua t'i qëndroj rrafshit institucional dhe njëherë dhe të shkresave zyrtare. Çështja e forumeve, çështjet e kongreseve imagjinare, apo jo, nuk më përkasin mua dhe nuk dua t'i hyj fare këtyre çështjeve dhe debateve. Unë ju referova një shkresë zyrtare për efekt të këtij procesi dhe e solla këtu në vëmendjen tuaj dhe e depozitova në KQZ për efekt të këtij procesi që ka të bëjë me regjistrimin në Bashkinë e Kukësit. Se kush është institucioni, apo sekretari i përgjithshëm, nuk e vendos as unë dhe askush tjetër, përveç institucioneve zyrtare. Dihet botërisht që ka një konflikt në Partinë Demokratike dhe nuk dua t'i rikthehem më se ka dy vjet kjo çështje dhe nuk ka nevojë... dihet që ka një konflikt dhe institucionet janë në diskutim e sipër dhe sikundër kemi dhe shkresën, çdo gjë është në gjykatë. Jemi në procese që ende nuk kanë përfunduar. Kështu që, ne këtu nuk kemi njohur asnjë gjë dhe nuk kemi shprehur asgjë tjetër, përveç çfarë i referohet regjistrimit për Bashkinë e Kukësit dhe vetëm kaq, faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Po, zoti Sefa!

**Z. I. Sefa, përfaqësues i PDSH-së:** Një pyetje dua ti bëj! Në dijeninë tuaj edhe në rast se dispononi ndonjë provë, a ka ndonjë masë nga Gjykata e Tiranës për pezullimin e aktivitetit ose pesullimit të ushtrimit të detyrës zotit Lulëzim Basha si kryetar i Partisë Demokratike? Faleminderit!

**Z. F. Nuri, përfaqësues i PD-së:** Nuk jam vënë në dijeni të një vendimmarrjeje të tillë, por meqenëse ma rikujtuar çështjen, përfitoj nga rasti që t'ju pyes dhe ju! Zoti Sefa, ju keni paraqitur në mars vërtetimin... ku duhet të figurojë zoti Basha. Zoti

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.4.09.2023*

Basha nuk u konsiderua si kryetar i Partisë Demokratike. Nga ana e institucioneve të KQZ-së, në fletën e votimit u vendos emri i zotit Alibeaj. Tani ju sillni të njejtin vërtetim? Atëherë, për çfarë u desh të bëhej procesi i rizgjedhjes së kryetarit tuaj?

**Z. I. Sefa, përfaqësues i PDSH-së:** Rizgjedhja e organeve drejtuese të partive politike, në bazë të ligjit, është në funksion të organizimit të brendshëm të partisë. Nuk ka detyrim partia politike ta çojë gjëkund. Në rast se... në gjykatë, siç e dini dhe ju, ligji detyron kur ndryshon kryetari i partisë çohet procedura e rizgjedhjes. Por të jeni të qetë, se tani sa është hapor gjykata, do t'i çojmë të gjitha procedurat në gjykatë dhe për këtë të jeni shumë të qetë dhe të bindur që gjykata do t'i vlerësojë. Por çfarë ka ndryshuar, ka ndryshuar! Më 29 korrik 2023, zoti Basha me votimin e anëtarëve të Partisë Demokratike u rizgjodh kryetar i Partisë Demokratike. Kjo është për organizimin e brendshëm të partisë. Unë ju pyeta konkretisht, ka ndryshuar ndonjë gjë? Ju më thatë, jo! Tani kam pyetje për Komisionerin. Vërtetimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë që kemi depozituar, i cikës datë është, i nderuar?


**Z. I. Celibashi:** Kam frikë se nuk mund të ma bëni dot këtë pyetje! Ju mund të deklaroni se të cilës datë e keni paraqitur atë!

**Z. I. Sefa, përfaqësues i PDSH-së:** Jo, se mund të thoni që unë deklaroj një gjë të gabuar, por është i datës 29 gusht 2023.

**Z. I. Celibashi:** Nuk ka pretendime për datën...

**Z. I. Sefa, përfaqësues i PDSH-së:** Tani, po bëjmë një debat që i shërben debatit tonë të brendshëm politik. Do të ndryshojë qeveria sot, t'i japim kohë të merren me

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.4.09.2023*

atë gjë, se është gjynah t'i hamë kohë atij debati të rëndësishëm që do të kemi sot. Po ju them, të mbarojmë diskutimin, vendimmarrja dihet. Është vendimmarrje e kryer këtu... historike e KQZ-së. Ne vijmë thjesht për të bërë procedurat dhe pak politike me njëri-tjetrin, por vendimmarrjen e dimë, Komisioner!

**Z. I. Celibashi:** E fundit!


**Z. F. Nuri, përfaqësues i PD-së:** Po dhe një koment të fundit në formë pyetje! Përderisa ju u shprehët zoti Sefa se “u rizgjodh zoti Basha”. Kjo do të thotë që nuk ka qenë, zoti Sefa?!

**Z. I. Sefa, përfaqësues i PDSH-së:** Referojuni dokumentacionit ligjor të paraqitur nga Partia Demokratike dhe të kuptoni se kush e drejton Partinë Demokratike. Kryetar imagjinar, këshilla kombëtarë imagjinar dhe struktura imagjinare mund të kemi kur të duam, si të duam dhe çfarë të duam. Këtu mund të vijë e të regjistrohet edhe Partia Republikane e Amerikës, të regjistrohet për zgjedhjet e Kukësit, po duhet të ketë dhe disa dokumente, apo jo?! Nuk mjafton të hapësh gjyq, duhet ta fitosh gjyqin. Mund të kërkosh në gjyq “sahatin e Tiranës”, ta prishim dhe të bëjmë një kullë 64-kate, po nuk ta jep njeri. Duhet ta fitosh gjyqin e pastaj të vish.

**Z. F. Nuri, përfaqësues i PD-së:** Mos ka lidhje rizgjedhje për faktin se ju pikërisht në gjyq...

**Z. I. Sefa, përfaqësues i PDSH-së:** Kur ta fitoni gjyqin...

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.4.09.2023*

**Z. F. Nuri, përfaqësues i PD-së:** Pikërisht në gjyq, ju e keni pranuar se ka dhënë dorëheqje.

**Z. I. Sefa, përfaqësues i PDSH-së:** Kur ta fitoni gjyqin, ejani këtu bashkë me këtë që keni depozituar, ejani përsëri.

**Z. F. Nuri, përfaqësues i PD-së:** Rizgjedhja e zotit Basha, sipas jush, ka ardhur për faktin sepse në mars ju keni pranuar në kolegji se ka dhënë dorëheqjen.

**Z. I. Sefa, përfaqësues i PDSH-së:** Kur të fitoni gjyqin, ejani përsëri dhe flasim atëherë. Për mua nuk ka më çfarë të diskutojmë!

**Z. I. Celibashi:** Nuk keni më! Zoti Sefa?!

**Z. I. Sefa, përfaqësues i PDSH-së:** Jo!

**Z. I. Celibashi:** Zoti Nuri?

**Z. F. Nuri, përfaqësues i PD-së:** Jo, faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Mirë, faleminderit! I konsiderojmë të mbyllura diskutimet dhe debatin në lidhje me këtë çështje. Në vlerësimin tim, të të gjithë dokumentacionit të paraqitur nga të dy kërkuesit në lidhje me kërkesën për t'u regjistruar Partia Demokratike si subjekt zgjedhor, vlerësoj se kërkesa e paraqitur nga zoti Lulëzim Basha, plotëson të gjitha kërkesat e Kodit Zgjedhor dhe ligjit "Për Partitë Politike". E kemi bërë këtë diskutim dhe debat dhe unë kam bërë të njetin arsyetim sikurse dhe


*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.4.09.2023*

sot në lidhje me kushtet që duhet të plotësohen për regjistrimin e një partie politike si subjekt zgjedhor. Tejt çdo diskutimi, apo parapëlqimi mendoj se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, si një organ administrativ, e ka tërësisht të pamundur që të bëjë një vlerësim dhe shqyrtim të të gjithë procesit vendimmarrës të një partie politike, si për rastin e zgjedhjes së organeve të saj drejtuese, apo dhe në përgjithësi për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të asaj partie. Për fat të mirë, apo të keq, varet se si gjithsecili e shikon, po për shkak të ligjit KQZ është e detyruar që ta shohë kërkesën për regjistrimin e një partie politike, thjesht dhe vetëm në aspektin formal. Të parit në aspektin formal, sipas përcaktimeve të ligjit, presupozon që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, të vlerësojë gjithë dokumentacionin që secila prej partive politike, depoziton në KQZ. Ajo çfarë është më e rëndësishme në tërësinë e këtij dokumentacioni, është një dokument i cili vjen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë si institucioni i vetëm të cilin njeh ligji “Për Partitë Politike”, për të regjistruar partitë politike si subjekte juridike, si parti politike, por dhe për të mbajtur regjistrin e tyre. Regjistër në të cilin janë të shënuara të gjitha të dhënat në lidhje me një parti politike, përfshirë këtu edhe emrin e kryetarit të partisë politike. Tejt faktit që ndoshta për dikë realitetet mundet të jenë të ndryshme, qoftë ato politike, po qoftë dhe ato juridike është fakt i pasqyruar në një dokument zyrtar që, kryetari i Partisë Demokratike të Shqipërisë është zoti Lulëzim Basha. Në këtë kontekst, ky person ka legjitimitetin për të paraqitur në emër të kësaj partie, kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor. Në këtë pozitë do të ishte pa vend e pa vlerë, të komentohej nga një pikëpamje tjetër, gjithë ecuria e procesit vendimmarrës të Partisë Demokratike, në lidhje me zgjedhjen e udhëheqësisë së saj, organeve të saj udhëheqëse. Ndaj jemi të detyruar t’i qëndrojmë strikt, asaj çfarë zyrtarisht prezantohet nga një institucion zyrtar, sikurse është Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë në lidhje me të dhënat për një parti politike. Ndërkohë në respektim të kërkesave të nenit 64 të Kodit Zgjedhor,

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*






*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.4.09.2023*

janë paraqitur edhe dokumenta të tjerë që kërkohen për regjistrimin e një partie politike si subjekt zgjedhor. Do të doja të theksoja këtu edhe dokumentin që ka të bëjë me deklaratën me shkrim të nënshkruar nga kryetari i partisë politike. Në respektim të plotë të atij qëndrimi që kam mbajtur dhe në rastin e shqyrtimit të kërkesës së kësaj partie për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e datës 14 maj 2023, e kërkuar, sot është plotësuar ky kusht i ligjit. Pra, kemi dhe deklaratën me shkrim të nënshkruar nga kryetari i partisë politike. Në vlerësimin tim ende si një kërkesë thelbësore për regjistrimin e një partie politike si subjekt zgjedhor. Si përfundim,

- Miratojmë kërkesën për t'u regjistruar Partia Demokratike, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023, me shkronjat nistore PDSH dhe me kryetar zotin Lulëzim Basha.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankimim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda tre ditëve nga shpallja e këtij vendimi.
- Këtë vendim e shpallim në faqen zyrtare elektronike të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, faleminderit!

**Vendimi nr. 745**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.4.09.2023*

4.09.2023  
Ora 12:43

**RENDI I DITËS**

*Projektvendimi “Për shqyrtimin e kërkesës së Partisë për Europeanizimin dhe Integrimin e Shqipërisë, për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Kukës, që do të zhvillohen më datë 24 Shtator 2023”.*

**PJESËMARRJA :**


- **KQZ:**
  - **Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**
  - **Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, Znj. P. Doçaj**
- **Parti Politike: PD (Z. F. Nuri)**
- **Të tjerë: KRIIK**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me çështjet e tjera!

**Z. Y. Merkaj:** Partia për Europeanizimin dhe Integrimin e Shqipërisë nëpërmjet kryetarit të saj zotit Rivelino Çuno, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Kukës. Ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve:

- Vërtetimin e lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë;
- deklarata e angazhimit solemn;
- deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike;
- emrin zyrtar të partisë;
- shkronjat nistore, emrin e kryetarit të partisë, emrin e financierit, emrin e personit përgjegjës për komunikim me KQZ-në dhe specimenin e vulës së partisë. Për sa më

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.4.09.2023*

sipër i paraqitet Komisionerit për shqyrtim dhe miratim projektvendimi “Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike “Partia për Europeanizim dhe Integrimin e Shqipërisë”, për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 Shtator 2023”, faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Atëherë, pranohet dhe kërkesa e partisë politike, Partia për Europeanizimin dhe Integrimin e Shqipërisë, për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023, me kryetar të partisë zotin Rivelino Çuno dhe me shkronjat nistore PEDSH.

**Vendimi nr. 746**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



**RENDI I DITËS**

**Projektvendimi “Për shqyrtimin e kërkesës së Partisë së Lirisë, për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Kukës, që do të zhvillohen më datë 24 Shtator 2023”.**

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ:**
  - **Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**
  - **Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, Znj. P. Doçaj**
- **Parti Politike: PD (Z. F. Nuri)**
- **Të tjerë: KRIIK**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë!

**Z. Y. Merkaj:** Partia e Lirisë, nëpërmjet kryetarit të saj zotit Ilir Metaj, ka paraqitur pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Kukës. Ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve:

- Vërtetimin e lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë;
- deklarata e angazhimit solemn;
- deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike;
- emrin adresën dhe shkronjat nistore të partisë;
- emrin e kryetarit të partisë, emrin e financierit, emrin e personit përgjegjës për komunikim me KQZ-në si dhe specimenin e vulës së partisë.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.4.09.2023*

Bashkëlidhur keni për shqyrtim dhe miratim projektvendimin e mësipërm, faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Mirë atëherë, miratohet kërkesa e partisë politike, Partia e Lirisë, për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023, me shkronjat nistore PL dhe me kryetar të partisë zotin Ilir Metaj.

**Vendimi nr. 747**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.4.09.2023*

4.09.2023  
Ora 12:46

**RENDI I DITËS**

**Projektvendimi “Për shqyrtimin e kërkesës së Partisë Socialiste të Shqipërisë, për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Kukës, që do të zhvillohen më datë 24 Shtator 2023”.**

**PJESËMARRJA :**


- **KQZ:**
  - **Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**
  - **Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, Znj. P. Doçaj**
- **Parti Politike: PD (Z. F. Nuri)**
- **Të tjerë: KRIIK**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë!

**Z. Y. Merkaj:** Partia Socialiste e Shqipërisë, nëpërmjet kryetarit të saj zotit Edi Rama, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Kukës, e cila ka paraqitur dokumentacionin si vijon:

- Vërtetimin e lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë;
- deklarata e angazhimit solemn;
- deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike;
- emrin adresën zyrtar të partisë;
- shkronjat nistore të partisë si dhe:
- emrin e kryetarit të partisë, emrin e financierit, emrin e personit përgjegjës për komunikim me KQZ-në si dhe në fund specimenin e vulës së partisë.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.4.09.2023*

Bashkëlidhur keni për shqyrtim dhe miratim projektvendimin e mësipërm, faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Atëherë, miratohet kërkesa e partisë politike, Partia e Socialiste e Shqipërisë, për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023, me shkronjat nistore PS dhe me kryetar të partisë zotin Edi Rama.

**Vendimi nr. 748**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.4.09.2023*

**4.09.2023  
Ora 12:47**

***RENDI I DITËS***

**Projektvendimi “Për plotësimin e vakancave në këshillat e bashkive: Pogradec, Dropull, Memaliaj, Librazhd, Belsh, Lezhë, Dibër dhe Kuçovë”.**

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ:**
  - **Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**
  - **Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, Znj. P. Doçaj.**
- **Parti Politike: S’ka prezent!**
- **Të tjerë: KRIIK**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me çështjet e tjera!

**Z. Y. Merkaj:** Në këshillin e bashkisë: Pogradec, Dropull, Memaliaj, Librazhd, Belsh, Lezhë, Dibër dhe Kuçovë kanë paraqitur kërkesë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës, për shkak të dorëheqjes së disa këshilltarëve. Këshilltarët vijues në listën shumememore që pretendojnë të marrin mandatin kanë depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, formularin e vetëdeklarimit. Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit rezulton se asnjëri prej tyre nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile si dhe nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore për të gjithë kandidatët për anëtarë të këshillave përkatës. Në përgjigje të kërkesës sonë asnjë prej kandidatëve nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë dhe informacioni i dërguar nga Zyra e Gjendjes Civile vërteton se nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile. Në

**Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU**






*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.4.09.2023*

mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se të dhënat e të gjithë kandidatëve për anëtarë në këshillat bashkiakë që citova pak më parë, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit. Bashkëlidhur keni për shqyrtim dhe miratim projektvendimin dhe kërkesën tonë për t’u miratuar, faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Atëherë, vendosim:

- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Pogradec me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zotin Jovan Shkëmbi.
- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Dropull me kandidatin nga lista shumemërore e Koalicionit “Bashkë Fitojmë”, zotin Pandeli Kuremeno.
- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Memaliaj me kandidatin nga lista shumemërore e Koalicionit “Bashkë Fitojmë”, zotin Flamur Mushamataj.
- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Librazhd, me kandidaten nga lista shumemërore e Partisë Demokracia Sociale, zonjën Erjola Albrahimi.
- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Belsh me kandidaten nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zonjën Aurela Hysa.
- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Belsh me kandidaten nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zonjën Enkeleda Baftjar Kullolli.
- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Belsh me kandidaten nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zonjën Ervina Meta.
- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Lezhë me kandidaten nga lista shumemërore e Partisë Socialdemokrate, zonjën Adelina Toma.
- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Lezhë me kandidaten nga lista shumemërore e Partisë Socialdemokrate, zonjën Vera Deda.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.4.09.2023*

- Plotësimin e vakancës po në Këshillin e Bashkisë Lezhë me kandidaten nga lista shumemërore e Partisë Socialdemokrate, zonjën Flora Margjonaj.
- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Dibër me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialdemokrate, zotin Andrit Lika dhe e fundit:
- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Kuçovë me kandidaten nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zonjën Aurela Rrumbullaku.

Çështje të tjera për rend dite?! Nuk kemi! Mirë, seanca mbyllet, faleminderit!

**Vendimi nr. 749 - 760**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

